



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

BERAT

Adresa: Lagja " Iliria ", Rruga "Antipatrea", Berat, Tel ,Fax : 032234246

Nr. 029/1 prot

Berat, me 03/02 2024

KONTRATË SHERBIMI

Kjo kontrate lidhet sot ne date 03/02 2024 ndermjet palëve të mëposhtme:

AUTORITETI KONTRAKTOR: Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat përfaqësuar nga, Kryetare KLEJDA MEÇI (ÇAPJA), me adresë: Lagja "10 Korriku " , Rruga "Antipatrea", Berat, që më poshtë do të quhet **Autoriteti Kontraktor**, dhe

KONTRAKTUESI: Operatori Ekonomik "IN PRINT" shpk me Nipt **L92713601Q**, me status aktiv, me adresë: Rr. Xhorxh Sorros, nr. 1524, Gjirokaster, me përfaqësues ligjor Z. Edmond Kushi, i cili në termat e përdorura në këtë kontratë do të njihet me emrin "**Kontraktuesi**".

BAZA LIGJORE: Kontrata hartohet në bazë të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Ligjin nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative".

Palët me vullnetin e tyre të lirë bien dakort si më poshtë:

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate eshte "Sherbime printimi/fotokopjimi/skanimi A4 bardhe/zi/ngjyra" sipas kushteve ne vijim te kontrates per institucionin Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat . Pajisjet e vena ne dispozicion nga shoqeria jane sipas kerkesave te kerkuara ne dokumentat e tenderit.

Neni 2

Vlera e Kontratës

Detyrimi për shërbimin i printimit/fotokopjimi, është pagesa e numërit të fletëve të printuara ose fotokopjuara, kjo sipas përcaktimit në formularin e ofertes. Vlera totale e kontratës është si më poshtë:

1. Çmimi total i kontratës pa TVSH është: **955.000 lek/ pa TVSH**
(**nentëqind e pesëdhjetë e pesë mijë**)
2. Çmimi total i kontratës me TVSH është: **1.146.000 lek/ me TVSH**
(**një milion e njëqindë e dyzet e gjashtë mijë**)

Në këto çmime janë të përfshira: pajisjet, toneri, mirëmbajtja dhe servisi, ndërrimi i pjesëve të dëmtuara (me përjashtim të dëmtimve të shkaktara nga jashtë).

Në çmim nuk përfshihet: dëmtimet që paraqiten si rezultat i faktorit njeri, dëmtime fizike, ndërhyrje të personave të pa autorizuar, letër jociësore, dëmtimet që vijnë nga furnizimi jo i rregullt me energji elektrike.

Neni 3.

Afati i Kontratës

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat merr në shërbim me afat deri në 31.12.2024 për pajisjet printer/fotokopje/skaner për sasinë përcaktuar në formularin e ofertes. Kontrata përfundon në **date 31.12.2024** ose me realizimin e sasisë së printimeve A4, A3, bardh/zi dhe color. Afati mund të shtyhet nëse palet bien dakort mes tyre me marrëveshje me shkrim.

Neni 4

Qëllimi i Kontratës

Qëllimi i kësaj Kontrate është ofrimi i "Shërbimit të printimit/fotokopjimit/skanimit A4 bardh/zi/ngjyra" për nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, sipas objektit të përcaktuar në Nenin 1 të kontratës.

Instalimi do të kryhet menjëherë pas kërkesës nga institucioni.

Neni 5

Detyrimet e Autoritetit Kontraktor

1. **Autoritetit Kontraktor** detyrohet të kujdeset për pajisjet në fjalë dhe në rast të zgjidhjes së kontratës ta dorëzojë sendet në gjëndje të rregullt dhe pa dëmtime. Në rast të dëmtimeve të jashtme apo të cilat vijnë si rezultat i keqperdorimit, institucioni është i detyruar të paguajë për këto dëmtime. Dëmtimet llogariten në masën e vlerës aktuale në treg. Vlera aktuale e pajisjes duhet të jetë në proporcion të drejtë me vlerën e amortizimit dhe kohën e shfrytëzimit të sendit.

· 2. **Autoritetit Kontraktor** ka për detyrë të përdorë Objektivin e kësaj kontrate, vetëm sipas qëllimit dhe destinacionit të parashikuar në nenin 1 të kësaj kontrate dhe detyrimeve të tjera ligjore për ushtrimin e aktivitetit ekonomik të tij.

Neni 6

Detyrimet e Kontraktuesit

1. Detyrohet të dorëzojë, pajisjet printer/fotokopje/skaner, siç përcaktohet në nenin 2 të kontrates.
2. Detyrohet të përgjigjet brenda 48 orëve për defektet e pajisjeve ose të ndërrojë pajisjen me një tjetër me kushte të njëjta, në rast se riparimet marrin kohë me shumë se një ditë. Zëvendësimi i saj me një tjetër bëhet në rast kur pajisja si rezultat i amortizimit ose i shkaqeve të tjera kërkon ndërhyrje të shpeshta.
Detyrohet të përgjigjet brenda 48 orëve për konfigurimin e pajisjeve që ofrojnë.
3. Është i detyruar të kryejë shpenzimet e transportit, sa herë që të kërkohet nga **Autoritetit Kontraktor** servisimi i pajisjes, apo edhe në qoftë se **Autoritetit Kontraktor** e sheh të arsyeshme se pajisja ka nevojë për servis.
4. Detyrohet të shoqërojë pajisjet me kataloge ose broshurë.

Neni 7

Mënyra e Pagesës

Pagesa e vlerës së shërbimit do të bëhet çdo muaj nga **Autoritetit Kontraktor** në llogarinë së **Kontraktuesit** në bazë të numrit mesatar mujor A4 të llogaritur nga AK. Në rast të tejkalimit mujor meastar të faqeve të printuara nga AK atëherë ato i shtohen fatures në vlerën e fleteve të printuara gjatë atij muaji. Shuma mujore do të paguhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e fatures.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

Me mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 3, kjo kontratë zgjidhet.

Kontrata zgjidhet para afatit në këto raste :

- Me marrëveshje midis palëve
- Kur palët shkelin detyrimet e marra përsiper.
- Në rast të mospagimit të fatures brenda 60 ditëve, **Kontraktuesi** ka të drejtë të prishë kontratën.



Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kur ka mosmarrëveshje midis palëve, ato zgjidhen me mirëkuptim, me nje komunikim shkresor mes palëve. Në të kundërt palët mund t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Berat.

Neni 10

Hyrja në fuqi


Kjo Kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe e shtrin efektin e saj , deri në datën 31.12.2024.

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, 3 (tre) për **Autoritetin Kontraktor** dhe 1 (një) për **Kontraktuesin** , dhe pasi lexohet, firmoset rregullisht nga palët.

Per Kontraktuesin
Firma "IN PRINT SHPK."

Administratori

Edmond Kushi



Per Autoritetin Kontraktor
Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat

KRYETARE

KLEJDA MEÇI (ÇAPJA)

